



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:183878
Datë: 11.06.2024
Numri i dokumentit: 05805048

C.nr.6109/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditësit M.R nga P, tani me vendbanim në Z, i përfaqësuar në bazë të autorizimit nga B.T, avokat me seli në P, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga V.R-M - zyrtare ligjore, me objekt kontesti pengimin e posedimit, vlera e kontestit e pa caktuar, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor - publik të dt.04.06.2024, në prezencën e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, me datë 11.06.2024, mori dhe në të njejtën ditë përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit M.R nga P, përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës, që të mënjanojë dhe zhvendosë betonin dhe materialin tjetër nga pjesa e rrugës e cila shtrihet në ngastrën kadastrale 652-0 - në sipërfaqe prej 19.58 m², distanca nga muri ekzistues deri te kufiri i parcelës: e para 1.61 metra, e dyta 0.69 cm, e treta 0.47 cm, e katërta 1.72 metra dhe e pesta 1.56 metra; pjesa e rrugës e cila shtrihet në ngastrën kadastrale 651-0 - në sipërfaqe prej 19.84 m², distanca nga muri ekzistues deri te kufiri i parcelës: e para 1.53 metra, e dyta 1.29 metra dhe e treta 1.44 metra; pjesa e rrugës e cila shtrihet në ngastrën kadastrale 649-0 - në sipërfaqe prej 8.4 m², distanca nga muri ekzistues deri te kufiri i parcelës: e para 1.54 metra dhe e dyta 1.11 metra.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure.

A r s y e t i m

- Rrjedha e procedurës dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse -

Paditësi M.R nga P, tani me vendbanim në Z, përmes përfaqësuesit të autorizuar, B.T, avokat me seli në P, pranë kësaj Gjykate me dt.16.08.2021 ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti pengimin e posedimit. Në padi ndër tjera theksohet se paditësi është pronar dhe posedues i ngastrave kadastrale 00652-0, 00651-0-291-0 dhe 00649-0, fakt ky i cili vërtetohet në bazë të provave materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës. Më tej theksohet se i njejtji gjendet me vendqëndrim në Zvicër dhe me datë

17.07.2021 është kthyer në Kosovë, me ç'rast duke hyrë në oborrin e tij është penguar për shkak të vendosjes së trotuarit të betonit, duke shtuar se ka konstatuar se e paditura e ka uzurpuar pronën e tij për interes publik, e ka bërë zgjerimin e rrugës në dëm të pronës së tij private, pasi me rastin e vendosjes së anësoreve e ka vështirësuar/penguar hyrjen në oborr. Tutje pretendohet se e paditura nuk ka zhvilluar bisedime paraprake me paditësin si dhe nuk e ka marrë pëlqimin e të njejtit për zgjerimin e rrugës në pronë private, duke konsideruar se ky veprim nuk ka qenë i domosdoshëm, pasi që prona e paditësit nuk e pengon realizimin e objektivave të Komunës në interesin e publikut. Marrja e pronës në këtë mënyrë, pretendon se i kufizon mundësitë e paditësit për realizimin e planeve jetësore e biznesore, andaj i është drejtuar të paditurës me kërkesë për evitimin e pengimit të posedimit, respektivisht kthimin në gjendje të mëparshme, duke e hequr materialin ndërtimor të vendosur në atë pronë si dhe anësoret me të cilat është penguar hyrja, por e paditura nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për evitimin e këtij pengimi. Më tej paditësi i është referuar dispozitave të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore Nr.03/L-154, neneve 113 dhe 114 të këtij ligji, duke shtuar se padinë e ka parashtruar brenda afateve subjektive dhe objektive.

Në seancën përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi me autorizim i paditësit, av. B.T, ndër tjera ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë pretendimeve në padi, duke shtuar se pavarësisht që prona e paditësit shfrytëzohet për interes publik, e paditura nuk mund të thirret në servitut apo në dispozita tjera për shfrytëzimin e pronës së paditësit. Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka propozuar që të nxirret ekspertizë e gjeodezisë me këqyrje në vendin e ngjarjes. Pas pranimit të ekspertizës dhe sqarimeve plotësuese nga eksperti gjeodet, është bërë precizimi i kërkesëpadisë, duke i propozuar Gjykatës që të detyrohet e paditura që të mënjanojë dhe zhvendosë betonin mbi sipërfaqet e cekura në konstatimin e ekspertit, e cila duhet të jetë "ad litem" pjesë e petitumit të kërkesëpadisë. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se pas analizimit, konstatimit dhe sintetizimit të tërësishëm të pretendimeve dhe bazuar në provat e administruara, u vërtetua se paditësi është pronar dhe posedues i ngastrave kontestuese, ndërsa e paditura e ka zgjeruar dhe betonuar rrugën në sipërfaqet e përshkruara sipas konstatimit të ekspertit, duke e penguar në posedim si dhe duke e dëmtuar, andaj e njejta duhet ta lirojë pjesën e pronës të cilën e ka uzurpuar dhe në përputhje me konstatimet e ekspertit të heqë betonin dhe materialin tjetër nga sipërfaqja kontestuese.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar në fjalë përfundimtare dhe atë: për taksë për padi shumë prej 50.00 Euro, për përpilimin e ekspertizës shumë prej 150.00 Euro, për përpilim të padisë shumë prej 104.00 Euro, për 4 seanca të mbajtura shumë prej 135.00 Euro, apo shumë e përgjithshme prej 844.00 Euro.

E paditura, fillimisht përmes përgjigjes në padi të deponuar në Gjykatë me dt.01.11.2023, e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, fillimisht mbi bazën e pretendimit se i njejti nuk ka ofruar prova të mjaftueshme dhe të besueshme me të cilat do të argumentonte të drejtën e tij për pengim posedimi, duke shtuar tutje se provat e cekura në padi nuk janë të vlefshme.

Në seancën përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor dhe në fjalë përfundimtare ka

theksuar se mbeten në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke theksuar se përkundër faktit që paditësi pretendon që padinë e ka ushtruar brenda afatit ligjor, në padi ekziston mospërputhje sa i përket dateve. Tutje pretendohet se paditësi me asnjë provë nuk ka arritur ta argumentojë se e paditura ka ndërmarrë ndonjë veprim me të cilin e ka penguar paditësin në posedimin e pronës së tij. Në raport me ekspertizën nga lëmia e gjeodezisë, nuk kanë parashtruar vërejtje. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që kërkesëpapia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

- Gjendja faktike e vërtetuar mbi bazën e provave të administruara -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.28.03.2024, në cilësinë e provave materiale, ka administruar provat si në vijim:

Kërkesa me numër protokoli 144513/21, e protokolluar me datë 22.07.2021; Aktvendimi mbi shqyrtimin e trashëgimisë LRP.Nr.0327/18, i dt.09.01.2018, i përpiluar në Zyrën e Noterit I.A; Kopja e pasaportës për paditësin; Kopja e biletës së udhëtimit të paditësit e dt.17.07.2021; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1826/13, i dt.05.03.2018; Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1826/13, i dt.29.05.2018; Kopja e planit për njësinë kadastrale P-71914066-00652-0, e dt.01.12.2017; Ekspertiza nga lëmia e gjeodezisë, e përpiluar nga eksperti F.M me dt.28.02.2024, plotësimi i kësaj ekspertize me sqarimet plotësuese.

Gjykata në mbështetje të dispozitës nga neni 8 të LPK-së, me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar secilën provë veç e veç, e më pas të gjitha provat së bashku, me ç'rast ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Sipas kërkesës me numër protokoli 144513/21, të dorëzuar pranë të paditurës me datë 22.07.2021, paditësi e ka njoftuar këtë të fundit lidhur me faktin se është pronar dhe posedues i ngastrave kadastrale 00652-0, 00651-0-291-0 dhe 00649-0. Më tej theksohet se i njejtë gjendet me vendqëndrim në Zvicër dhe me datë 17.07.2021 është kthyer në Kosovë, me ç'rast duke hyrë në oborrin e tij është penguar të hyjë për shkak të vendosjes së trotuarit të betonit, duke shtuar se ka konstatuar se e paditura për interes publik e ka bërë zgjerimin e rrugës në dëm të pronës së tij private, pasi me rastin e vendosjes së anësoreve e ka vështirësuar/penguar hyrjen në oborr. Tutje theksohet se e paditura nuk ka zhvilluar bisedime paraprake me paditësin si dhe nuk e ka marrë pëlqimin e të njejtit për zgjerimin e rrugës në pronë private, duke konsideruar se ky veprim nuk ka qenë i domosdoshëm, pasi që prona e paditësit nuk e pengon realizimin e objektivave të Komunës në interesin e publikut. Marrja e pronës në këtë mënyrë, pretendon se i kufizon mundësitë e paditësit për realizimin e planeve jetësore e biznesore, andaj i është drejtuar të paditurës me kërkesë për evitimin e pengimit të posedimit, respektivisht kthimin në gjendje të mëparshme, duke e hequr materialin ndërtimor të vendosur në atë pronë si dhe anësoret me të cilat është penguar hyrja në pronën e tij.

Nga kopja e pasaportës së paditësit M.R, rezulton se i njejt i mban shtetësinë zvicerane, ndërsa nga kopja e biletës së udhëtimit e dt.17.07.2021, vërtetohet fakti se i njejt i në datën e lartëcekur ka udhëtuar nga qyteti i Zurichut në Prishtinë.

Në bazë të aktvendimit mbi shqyrtimin e trashëgimisë, LRP.Nr.0327/18, i dt.09.01.2018, të përpiluar në Zyrën e Noterit I.A, është bërë shqyrtimi i trashëgimisë pas vdekjes së të ndjerit A.R, ish nga P. Pasuria e cila ka qenë objekt shqyrtimi në këtë procedurë është përbërë nga paluajtshmëritë e evidentuara me numrat e njësive kadastrale si në vijim: P-71914066-00510-0; P-71914066-00650-0 dhe P-71914066-00652-0. Me këtë rast, si trashëgimtarë ligjorë të të njejtit janë shpallur F.R, A.R dhe këtu paditësi M.R.

Në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1826/13, të datës 05.03.2018, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësve F.R, M.R, A.R, A.R, B.R, K.R dhe B.R, të gjithë nga fshati S, F.L dhe M.L të gjithë nga S, Komuna P, është anuluar kontrata për shitblerjen e lidhur me datë 02.08.2012, në Prishtinë dhe e vërtetuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë Vr.2704/12, në mes të paditurit të parë B.J dhe të paditurit të dytë I.S, për ngastrën kadastrale nr. 577-0, në vendin e quajtur "T" me sipërfaqe 1386 m², dhe ngastra kadastrale nr. 579-2, në vendin e quajtur "L" me sipërfaqe prej 498 m², ZK S. Po ashtu është vërtetuar se paditësit janë bashkëpronarë nga baza juridike e kontratës së shitblerjes dhe atë: paditësi F.R për 2/8 pjesë ideale, kurse paditësit M.R, A.R, A.R, B.R, K.R, dhe B.R, secili nga 1/8 pjesë ideale për ngastrat si vijon: nr. 307, vendin e quajtur "R" me sipërfaqe prej 4137 m², nr.328 në vendin e quajtur "L" me sipërfaqe prej 1392 m², nr.533 në vendin e quajtur "J" me sipërfaqe prej 1469 m², nr.541-0 vendi i quajtur "J" me sipërfaqe prej 951 m², nr. 637 në vendin e quajtur "J" me sipërfaqe prej 486 m², nr. 638, në vendin e quajtur "Q" me sipërfaqe prej 3279 m², nr.649-0 në vendin e quajtur "O", shtëpi me sipërfaqe prej 193 m², dhe oborr me sipërfaqe prej 193 m², dhe oborr me sipërfaqe prej 500 m², dhe kullosë me sipërfaqe prej 565 m², me sipërfaqe të përgjithshme 1258 m²,nr. 577-0, në vendin e quajtur "T" me sipërfaqe prej 1386 m², dhe nr.579-2, në vendin e quajtur "L" me sipërfaqe 498 m², të gjitha në Zonën Kadastrale S. Po ashtu ka detyruar të paditurit B.J dhe I.S, t'i lejojë paditësit të regjistrojnë të drejtën e tyre pronësore pranë organeve kompetente.

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1826/13, të dt.29.05.2018, është bërë përmirësimi i gabimeve teknike në aktgjykimin e lartëcekur C.nr.1826/13, të dt.05.03.2018.

Sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, është bërë nxjerrja e provës përmes ekspertizës nga lëmia e gjeodezisë me këqyrjen në vendin e ngjarjes, me ç'rast për ekspert është caktuar F.M, i përzgjedhur nga lista e ekspertëve gjyqësorë. Eksperti përkatës, me rastin e këqyrjen në vend të zhvilluar me dt.15.01.2024, ka përpiluar mendimin dhe konstatimin me shkrim, të konkretizuar me dt.28.02.2024. Në këtë mendim, ndër tjera ka konstatuar se: "*Pas identifikimit dhe shiqimit në vend të ngjarjes, duke iu referuar edhe historiatit kadastral për parcelat nr.652-0, 651-0 dhe 649-0, ka konstatuar se në këto parcela shtrihet një pjesë e rrugës, e cila është asfaltuar apo ndërtuar nga Komuna e Prishtinës. Tutje është konstatuar se po ashtu është i vendosur edhe një muri ekzistues i cili rrethon këto parcela, ku nga ky mur, deri te kufiri zyrtar, rruga shtrihet në këto sipërfaqe: Në parcelën nr.652-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej*

431 m2, e cila figuron në emër të F.R, A.R dhe M.R, shtrihet rruga e ndërtuar në sipërfaqe prej 19.58 m2; në parcelën me nr.651-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 489 m2, e cila figuron në emër të M.R, shtrihet rruga e ndërtuar në sipërfaqe prej 19.84 m2; në parcelën nr.649-0, e cila figuron në emër të B.J, shtrihet rruga e ndërtuar në sipërfaqe prej 8.4 m2.”

Në kuptim të dispozitës nga neni 362 par.1 të LPK-së, eksperti i lartëcekur ka prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesor për të mbrojtur mendimin dhe konstatimin me shkrim, ndërsa në sqarimin plotësues, i njejtë ka specifikuar edhe distancat nga muri ekzistues deri te kufiri i parcelave kontestuese si në vijim: *“në parcelën 652-0 - ku shtrihet rruga në sipërfaqe prej 19.58 m2, distanca nga muri ekzistues deri te kufiri i parcelës: e para 1.61 metra, e dyta 0.69 cm, e treta 0.47 cm, e katërta 1.72 metra dhe e pesta 1.56 metra; në ngastrën kadastrale 651-0, ku shtrihet rruga në sipërfaqe prej 19.84 m2, distanca nga muri ekzistues deri te kufiri i parcelës: e para 1.53 metra, e dyta 1.29 metra dhe e treta 1.44 metra; në ngastrën kadastrale 649-0, ku shtrihet rruga në sipërfaqe prej 8.4 m2, distanca nga muri ekzistues deri te kufiri i parcelës: e para 1.54 metra dhe e dyta 1.11 metra.”*

- *Baza ligjore dhe vlerësimi i Gjykatës -*

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të mbështetjes së kërkesëpadisë, gjegjësisht pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, bazuar në natyrën dhe periudhën e lindjes së raportit juridik, duhet t'i referohemi dispozitave të Ligjit Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 15.06.2009 dhe i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit. Dispozita nga neni 111 e këtij ligji, në paragrafin 1 përcakton që: *"Personi i cili e privon nga posedimi poseduesin ose e pengon në posedim kundër vullnetit të poseduesit vepron kundërligjshëm, përveç nëse privimi ose pengimi lejohen shprehimisht me ligj".* Në bazë të dispozitës së lartëcekur rrjedh se pengimi i posedimit mund të vijë në shprehje në dy mënyra: 1) përmes privimit nga posedimi ndaj një sendi të caktuar dhe 2) përmes pengimit nga posedimi i qetë të atij sendi. Në anën tjetër, dispozita nga neni 113, par.1 dhe 2 përcakton: *"Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta. Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore".* Dispozita e lartëcekur ofron mbrojtje juridike për secilin mbajtës të sendit apo një të drejtë të caktuar, qoftë nga privimi i posedimit, ashtu edhe nga pengimi në posedim. Gjykata iu referua edhe dispozitës nga neni 114 të këtij ligji, e cila përcakton afatet brenda të cilave duhet të paraqitet një kërkesë e tillë, e ku shprehimisht përcaktohet që: *"Kërkesa mund të parashtrohet vetëm në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi që poseduesi e merr dijeni lidhur me privimin apo pengimin e posedimit të tij. Kërkesa shuhet pas kalimit të një viti nga privimi ose pengimi i posedimit".* Së fundmi, Gjykata iu referua edhe dispozitave të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i cili në nenin 480 përcakton që: *"Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përrjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përrjashtohet mundësia që në kontestet*

për shkak të pengimit të posedimit të parashtrohet kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit."

Gjykata fillimisht vlerëson se duhet trajtuar pretendimi i të paditurës lidhur me çështjen e afatshmërisë së padisë dhe në përgjigje ndaj këtij pretendimi, erdhi në këtë përfundim: Në rastin konkret, paditësi pretendon se lidhur me pengimin në posedimin e pronës së tij është vënë në dijeni me datën 17.07.2021, ndërsa padia rezulton te jetë ushtruar në Gjykatë me datë 16.08.2021, përmes postës rekomande. Nisur nga ky fakt, rezulton se padia është ushtruar brenda afatit subjektiv prej 30 ditësh, të përcaktuar në dispozitën e lartëcekur nga neni 114 të LPDTS-së, andaj një pretendim i tillë i të paditurës është i pa themeltë.

Gjykata po ashtu e tërheqë vëmendjen tek fakti se paditësi, në mesin e provave materiale të bashkangjitura në padi, gjegjësisht të administruara në këtë procedurë, ka parashtruar edhe prova të tilla me qëllim të argumentimit të faktit se i njejtë është pronar i ngastrave kadastrale që janë objekt shqyrtimi në këtë çështje kontestimore (aktvendimi mbi shqyrtimin e trashëgimisë LRP.Nr.0327/18, i dt.09.01.2018, i përpiluar në Zyrën e Noterit I.A, si dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1826/13, i dt.05.03.2018). Gjykata vë në pah faktin se në procedurat e ngritura sipas padisë për pengim posedim, e gjithë veprimtaria procedurale që zhvillohet pranë Gjykatës është e përqendruar drejt konstatimit të gjendjes së fundit të posedimit dhe eventualisht konstatimit të pengimit. Thënë këtë, në procedura të kësaj natyre përjashtohet shqyrtimi i të drejtës mbi posedimin, bazës juridike të posedimit, ndërgjegjshmërisë së poseduesit, kërkesës për dëmshpërblim të dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është kryer akti që paraqet pengim posedimi etj.

Në bazë të interpretimit të dispozitave të lartëcituara nga nenet 111 dhe 113 të LPDTS-së, rrjedh se në rastet kur objekt shqyrtimi paraqitet pretendimi lidhur me pengimin e posedimit, duhet vlerësuar nëse kanë ardhur në shprehje dy rrethana bazike: 1) Të provuarit e faktit nëse subjekti i cili kërkon mbrojtje gjyqësore është posedues i sendit lëndor dhe 2) Të provuarit e faktit se subjekti ndaj të cilit është e drejtuar kërkesa ka ndërmarrë veprime të cilat konsistojnë në privim, respektivisht pengimin në posedimin e pronës të parashtruesit të kërkesës, kundër vullnetit të tij. Rrethanat e lartëcekura duhet vlerësuar në mënyrë kumulative.

Pretendimi kyç i palës paditëse në raport me pengimin e pretenduar në posedimin e pronës së tij mbështetet në faktin se i njejtë me rastin e kthimit në Kosovë nga vendqëndrimi i tij në Zvicër, është penguar të hyjë në oborr për shkak të vendosjes së trotuarit të betonit/anësoreve nga e paditura, e cila për interes publik ka bërë zgjerimin e rrugës në dëm të pronës së tij private. Nga këqyrja në vendin e ngjarjes me prezencën e ekspertit gjeodet, respektivisht ekspertiza nga lëmia e gjeodezisë, e plotësuar me sqarimet shtesë nga eksperti F.M, nuk është provuar fakti se e paditura ka vendosur trotuar të betonit mbi nivelin e rrugës në parcelat të cilat kanë qenë në posedimin e paditësit. Në pyetjen e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit në seancën e dt.04.04.2024, lidhur me faktin nëse ekziston ndonjë fotografim që dëshmon se në hapësirën ku pretendohet të ketë ndodhur pengimi i posedimit ka pasur të shtruara kubëza rreth 15-20 cm mbi nivelin e rrugës, eksperti është përgjigjur se fotografimi i fundit zyrtar për këtë ngastër është i vitit 2018, andaj një çështje e tillë nuk ka pasur mundësi të konstatohet.

Sa i përket sipërfaqes së rrugës së shtruar, po nga sqarimet e dhëna nga ana e ekspertit nga lëmia e gjeodezisë, është konstatuar se në kuadër të parcelës nr.652-0, shtrihet rrugë e ndërtuar në sipërfaqe prej 19.58 m², në kuadër të parcelës 651-0, shtrihet rrugë e ndërtuar në sipërfaqe prej 19.84 m², ndërsa në kuadër të parcelës 649-0, shtrihet rrugë e ndërtuar në sipërfaqe prej 8.4 m². Pala paditëse nuk ka ngritur ndonjë pretendim në drejtim të argumentimit të faktit se është posedues i tërësisë së sipërfaqes së rrugës së shtruar nga e paditura, ndërsa në pyetjen drejtuar ekspertit nëse një sipërfaqe e tillë e rrugës së ndërtuar paraqet pengesë për hyrjen e paditësit në oborrin e shtëpisë së tij, eksperti është përgjigjur se nuk paraqet ndonjë pengesë, duke sqaruar se hyrja kryesore e paditësit shtrihen në ngastrën nr.652-0.

Sa i përket ekspertizës nga lëmia e gjeodezisë, e plotësuar me sqarimet e dhëna nga eksperti përkatës, Gjykata ia fali besimin e plotë, për faktin se e njehta është përpiluar në mënyrë profesionale dhe në referim të të gjithë parametrave dhe standardeve të nevojshme që Gjykatës i kanë shërbyer për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore.

Një çështje thelbësore e cila duhet të jetë objekt trajtimi në këtë procedurë paraqet edhe fakti se në rastin konkret akti i pengimit të posedimit pretendohet të jetë kryer nga një organ shtetëror publik. Në praktikën gjyqësore mbizotëron një qëndrim dhe interpretim i konsoliduar që konsiston në faktin se organet shtetërore gjatë ushtrimit të veprimtarisë - aktivitetit të tyre nuk kryejnë akt të pengimit të posedimit. Në referatin e padisë, por edhe deklaratimet e parashtruara nga i autorizuari i paditësit gjatë seancave gjyqësore në këtë çështje juridike, veprimet e palës së paditur cilësohen si uzurpim i pronës së paditësit, ndërsa tutje aludohet në faktin se marrja e pronës së paditësit në dobi të interesit publik është bërë pa konsultim me të njejtin, nuk ka qenë e domosdoshme dhe përmes këtyre veprimeve, paditësit i është shkaktuar dëm, duke iu pamundësuar realizimi i objektivave biznesore. Gjykata vlerëson se pretendimet e karakterit të tillë, paditësi ka mundur t'i adresojë përmes inicimit të padisë për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë, apo eventualisht kërkesës për kompensimin e dëmit në paluajtshmëritë e tij, për faktin se siç u elaborua më sipër, në procedurën e pengim posedimit është i përjashtuar shqyrtimi dhe vendosja sipas kërkesave të kësaj natyre.

Mbi bazën e konstatimeve të tilla, Gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet refuzuar në tërësi si e pa bazuar, andaj vendosi decidivisht si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, në kuptim të dispozitës nga neni 142 par.3 të LPK-së, e cila përcakton që: "Mbi kërkesëpadinë gjykata vendosë me aktgjykim, kurse në procedurën sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit me aktvendim."

- Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës –

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës, nga pika II e dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore nga nenet 450 lidhur me nenin 463.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, për faktin se pala paditëse e ka humbur kontestin gjyqësor, kurse pala e paditur, si palë gjyqfituese nuk i ka kërkuar apo specifikuar shpenzimet e krijuara lidhur me këtë procedurë.

Mbi bazën e të lartëcekurave, në mbështetje të dispozitave nga nenet 142 par.3, lidhur me nenin 160 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL -
C.nr.6109/21, datë 11.06.2024

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të dispozitës nga neni 481 par.3 të LPK-së, palët e pakënaqura kanë të drejtën e ankesës në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.